



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1849 prot.

Fushë-Arrëz, më 27. 06. 2025

PROCESVERBAL (Zbardhur, më 27.06.2025)

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 26.06.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Bardhok Qafa; Besjana Marku; Franc Doda; Mustaf Pashkaj; Tereze Dema; Valentin Doçi; Valentina Lleshaj; Vjollca Tabakaj; Zef Cara**

(10 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje merr pjesë Kryetari i Bashkisë, **Z. Hil Curri**

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Qershor 2025! Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen (8 Këshilltarë fillimisht) e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.06.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 30.05.2025.
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak, datë 09.06.2025.
4. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Maj 2025.
5. Projektvendim për miratimin e Fazës së Parë të PBA-së 2026-2028.

6. Projektvendim për dhënie e dakordësisë për dhënie në përdorim të një sipërfaqeje pyjore publike prej 0.0719 ha për kanalin e linjës së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për shoqërinë "Uji Puka" Sh.P.K në zonën kadrastale me nr.1657 dhe nr.2686, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz". (Rishqyrtim i Vendimit Nr.56, datë 28.10.2024)
7. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
8. Të ndryshme.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Për arsye të forta personale, Këshilltari Mustaf Pashkaj ka kërkuar të largohet prandaj kërkoj të ndryshohet renditja e rendit të ditës ku pika Nr. 6 e rendit të ditës të trajtohet para pikës Nr.5. (Domethënë pikat 5 dhe 6 ndërrojnë vendet)

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 1 e rendit të ditës: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.06.2025.

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës përmes votimit me ndryshimin e kërkuar në renditje ku pika Nr.6 do të trajtohet para pikës Nr.5:

- Miratohet rendi i ditës me ndryshimin e kërkuar në renditje ku pika Nr.6 do të trajtohet para pikës Nr.5:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 2 e rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 30.05.2025. Nuk ka diskutime.

Atëherë ju ftoj të miratojmë me votë Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 30.05.2025.

- Miratohet Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 30.05.2025 me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 3 e rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak të datës 09.06.2025. Nuk ka diskutime.

Atëherë ju ftoj të miratojmë me votë Procesverbalin e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak të datës 09.06.2025.

- Miratohet Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 09.06.2025 me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 4 e rendit të ditës: Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Maj 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

Lindita Lleshi, Përfaqësuese e Zyrës së Emigracionit dhe Çështjeve Sociale, shpjegon se për muajin Maj 2025 kemi propozuar për ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, 30 familje, me fond 120,666 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,966,429 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën 118,630 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 15 familje me fond 50,758 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë .
3. Njësia Blerim , 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Fierzë , 3 familje me fond 19,424 lekë .
5. Njësia Iballë , 5 familje me fond 20,136 lekë .

Lindita Lleshi, Përfaqësuese e Zyrës së Çështjeve Sociale në Bashki, shpjegon se nuk shtohet në bllok-ndihmën e 6% asnjë familje apo individ për muajin Maj 2025 dhe se largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja: Valter Prela (Njësia Administrative Fierzë) për riaplikim në Ndihmë Ekonomike.

Znj. Lleshi gjithashtu tregon se trajtohen me ndihmën ekonomike prej 6% :

Të gjitha familjet që mund të dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme:

1. Liza Ndue Cenaj
2. Marjana Ded Kacoli
3. Mark Pjeter Marku
4. Misire Shaban Miftaraj
5. Vogel Mark Shpendi
6. Pranvera Nikoll Prebiracevic

Franc Doda, anëtar i Komisionit të Mirëqenies Sociale, shprehet se për këtë muaj nuk ka ndryshime të listës përveçse largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja Valter Prela (Njësia Administrative Fierzë) për riaplikim në Ndihmë Ekonomike. Kështu Komisioni ka rënë dakord me propozimet e Zyrës së Çështjeve Sociale për familjet që përfitojnë 6% të bllok-ndihmës ekonomike sipas listave të sjella.

Shënim 1: Ndërkohë në sallën mbledhjes në minutën e 5-të, këshilltarëve iu bashkohet, **Z.Bardhok Qafa**, anëtar i Këshillit Bashkiak. i cili është njohur edhe më parë me projektin përmes faqes web të bashkisë por edhe në rrjetin WhatsApp të Grupit të Këshilltarëve.

Franc Doda, anëtar i Komisionit të Mirëqenies Sociale

Për muajin që vjen punonjësit përgjegjës do të na sjellin informacionin e detajuar për secilin dhe pritet të ketë edhe ndryshime duke u bazuar në kriteret e përfitimit.

Shënim 2: Në minutën e 6-të të mbledhjes bëhet pjesë edhe këshilltari **Z.Valentin Doçi**, anëtar i Këshillit Bashkiak i cili është njohur edhe më parë me projektin përmes faqes web të bashkisë por edhe në rrjetin WhatsApp të Grupit të Këshilltarëve.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera dhe Komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Maj 2025 përmes votimit:

- **Miratohet** me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Maj 2025 **me:**

10 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Në fillim të mbledhjes miratuar rendin e ditës me një ndryshim në renditje: Pika Nr. 6 do të trajtohet përpara pikës Nr.5 të rendit të ditës. Atëherë referuar kësaj vazhdojmë me:

Pika numër 6 e rendit të ditës : Projektvendim për dhënien e dakordësisë për dhënie në përdorim të një sipërfaqeje pyjore publike prej 0.0719 ha për kanalin e linjës së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për shoqërinë "Uji Puka" Sh.P.K në zonën kadrastale me nr.1657 dhe nr.2686, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz". (Rishqyrtim i Vendimit Nr.56, datë 28.10.2024)

Për Drejtorinë e Aministrimit dhe Menaxhimit të Pyjeve që kanë sjellë projektin, fjala për Drejtorin, Z. Ardmir Doda:

Ardmir Doda, Drejtor i Aministrimit dhe Menaxhimit të Pyjeve:

Përshëndetje të gjithëve!

Referuar shkresës se Prefektit Nr.56, datë 14.11.2024, mbi Vendimin Nr. 56, datë 28.10.2024 të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, ku kërkohet rishikimi i aktit pasi i mungon çertifikata e pronësisë e tre muajve të fundit.

Gjatë kësaj kohe kemi kemi bërë aplikimin tre herë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ku kemi hasur jashtëzakonisht vështirësi me to për shkak të formës së strukturimit që ka kjo Agjenci, herë është kaluar në Tiranë si Drejtori Rajonale e Shkodrës e tani është rikthyer përsëri Shkodrës dhe përgjigjet janë të vonuara duke shkelur të gjitha afatet ligjore që ato kanë. Aplikimi është kryer direkt nga e-albania e Bashkisë Fushë-Arrëz. Në përgjigjen e parë që ka ardhë, për shërbimin ” verifikim online i gjendjes juridike të pronësisë dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme” janë bashkëlidhur kartelat e pasurive nr. 1318 dhe 1321 dhe janë pronë e Bashkisë Fushë-Arrëz, document që ka dalë nga e-albania. Gjithashtu në përgjigjen e ASHK Shkodër të datës 22.05.2025 thuhet se nga verifikimi i kryer i kartelës fizike për pasurinë nr.633 vol. 3 fq 110 zk 2686, Adresa e pasurisë Pukë, MICOJ. Sipërfaqja e pasurisë 16888 m² sipas In. Pronari i pasurisë është Bashkia Fushë-Arrëz. Tashmë kemi edhe konfirmimin e ASHK përmes shkresës në fjalë që këto pasuri janë të Bashkisë Fushë-Arrëz, siç kanë qenë edhe në projektvendim.

Ky dokument ju bashkangjitet dokumentave ekzistues që janë të njëjtët pa asnjë ndryshim.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ky projektvendim është miratuar edhe njëherë në mbledhjen e tetorit 2024, por Prefektura e ka kërkuar një dokument të tillë të cilin e tregoi Ardmiri. Ky është i vetmi dokument për të cilin Prefektura ka kërkuar të rishikohet Vendimi i mëparshëm. Dihet ligjshmërisht se pyjet janë pronë e shtetit por ne na duhej të dimë se cilit territor i përkasin zonat kadastrale për të cilat bëhet fjalë. Kërkojmë edhe njëherë Ardmirit të na shpjegojë skematikisht situatën e projektit.

Ardmir Doda, Drejtor i Administrimit dhe Menaxhimit të Pyjeve:

Burimi ujqor është në territorin e Bashkisë Pukë. Bashkia e Pukës e ka marrë një vendim për këtë dhe ka vazhduar procedurat. Ne kemi thjesht linjën që kalon nëpër territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz e cila do të jepet në përdorim sipas tarifave që janë të përcaktuara sipas VKM-së 559, datë 29.07.2022 dhe Udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016. Kjo dosje ka gjithë dokumentacionin e kërkuar, është bërë edhe dëgjesa publike.

Kemi edhe vendimin nr.12 datë 15.07.2024 nga Këshilli i Bazenit Ujqor Mat i cili është në dosje.

Besjana Marku, anëtare e Këshillit Bashkiak:

Unë vërej pasaktësi në dokumentin e ardhë nga ASHK-ja sepse viti 2025 nuk është viti i 80-vjetorit të çlirimit, por viti i 81-të, konkretisht te faqja e parë, dokumentit ka logon e 80-vjetorit

të çlirimit e cila s'mund të ndodhë në një dokument të dalë nga e-albania. Ka moskorrektësi në paraqitjen e këtij dokumenti, dokumenti nuk është i saktë. Dyshoj në këtë dokument. Përpos kësaj dokumenti në faqen e dytë në pjesën fundore, ngjitur me vulën ka shkrim të mbivendosur, çka mua më shton dyshimin për një document të saktë dhe të rregullt zyrtar. Dokumenti nuk është strukturuar në rregull. Unë dyshoj në ASHK-në për nxjerrjen e një dokumenti të parregullt. ASHK jua ka nisë gabim dokumentin.

Ardmir Doda, Drejtor i Administrimit dhe Menaxhimit të Pyjeve:

E nderuar zonjë, ne nuk lëshojmë dokumenta të tilla ne vetëm e kemi hapur nga e-albania e Bashkisë ku na e ka dërguar ASHK-ja dhe e kemi shkarkuar, dokumenti është me vulë elektronike i dalë nga e-albania. Dokumenti ka emra konkret dhe vula elektronik, hyni në e-albania e Bashkisë Fushë-Arrëz i keni dy dokumentet e shkarkuara. Në çdo kohë mund t'a verifikoni në e-albania e Bashkisë Fushë-Arrëz, i keni dy dokumentat e shkarkuar. Dokumenti është me vulë elektronike dhe mua në këtë rast më intereson përmbajtja e dokumentit dhe jo ajo logo që institucioni mbase ka harruar ta heqë.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju zonja këshilltare po pretendoni se dokumenti është i fallsifikuar, unë ju sugjeroj të kontrolloni e-albania e bashkisë sepse dokumenti mban një vulë e cila heq çdo aludim për fallsifikim. Nëse ju zonjë keni dyshime për dokumentacionin e lëshuar nga sistemi kombëtar ju mund të votoni kundër dhe ne si institucion do ti bëjmë kërkesë ASHK-së për verifikimin e dokumentit lidhur me parregullsitë që ju pretendoni.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Vazhdojmë me procedurën e mbledhjes, ftoj këshilltarët të miratojmë me vote Projektvendim për dhënien e dakordësisë për dhënie në përdorim të një sipërfaqeje pyjore publike prej 0.0719 ha për kanalin e linjës së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për shoqërinë "Uji Puka" Sh.P.K në zonën kadrastale me nr.1657 dhe nr.2686, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz". (Rishqyrtim i Vendimit Nr.56, datë 28.10.2024)

- **Miratohet** Projektvendimi për dhënien e dakordësisë për dhënie në përdorim të një sipërfaqeje pyjore publike prej 0.0719 ha për kanalin e linjës së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për shoqërinë "Uji Puka" Sh.P.K në zonën kadrastale me nr.1657 dhe nr.2686, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz". (Rishqyrtim i Vendimit Nr.56, datë 28.10.2024) **me:**

9 vota pro

1 votë kundër

0 vota abstenim

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak:

Vota kundër është e Këshilltares, Besjana Marku dhe arsyeja e kësaj vote kundër është se ajo dyshon se dokumenti i dalë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, dërguar Bashkisë Fushë-Arrëz, në e-abania-n e Bashkisë është i parregullt. Ajo thotë se nëse dokumenti do të ishte i rregullt, logoja e 80-Vjetorit të Çlirimit nuk duhej të ishte përdorur në shkresën e vitit 2025. Gjithashtu dokumenti në fjalë në faqen e dytë në pjesën fundore, ngjitur me vulën ka shkrim të mbivendosur, çka Këshilltares i shton dyshimin për një dokument të pasaktë dhe të parregullt zyrtar.

Shënim 3: Kishte një lapsus fillimisht në interpretimin e miratimit të këtij projektvendimi por bazuar në Nenin 54 dhe Nenin 55 të ligjit 139/20215, “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, qartësohem se 9 vota pro mjaftojnë që ky projektvendim të miratohet.

Shënim 4. Në minutën e 25-të të mbledhjes largohet nga mbledhja këshilltari Mustaf Pashkaj siç ishte njoftuar dhe kërkuar para fillimit të mbledhjes, kjo për arsye të forta personale.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Në fillim të mbledhjes miratuam rendin e ditës me një ndryshim në renditje: Pika Nr. 5 do të trajtohet pas pikës Nr.6 të rendit të ditës. Atëherë referuar kësaj vazhdojmë me:

Pika numër 5 e rendit të ditës: Miratimi i Projektvendim për miratimin e Fazës së Parë të PBA-së 2026-2028.

Dritan Lika, Drejtor i Zyrës së Financës:

Përshëndetje të gjithëve!

Zyra e Financës dhe Buxhetit ka përgatitur Fazën së Parë të PBA-së 2026-2028.

Drafti i Fazës së Parë të PBA-së 2026-2028 është ngarkuar në sistem dhe është dërguar në Ministrinë e Financës Brenda afateve ligjore ku një nga përcaktimet ligjore është edhe miratimi në Këshillin Bashkiak Brenda muajit Qershor të vitit.

PBA-ja e Bashkisë Fushë-Arrëz është projektbuxhet 3-vjeçar ku si çdo projektbuxhet ka të ardhurat e Bashkisë për periudhën që vijnë nga :

- 1.Taksat dhe Tarifat Vendore të cilat janë programuar duke u bazuar ne Paketën fiskale te vitit 2025.
- 2.Transferta e pakushtëzuar.
- 3.Transferta specifike.
4. Transferta e kushtëzuar.

Këto të ardhura janë të shprehura edhe në mënyrë tabelare (prezantimi në ekranin e sallës).

Gjithashtu këto të dhëna janë të shprehura edhe në mënyrë grafike ku duket qartë trendi në rritje i të ardhurave. (prezantimi në ekranin e sallës).

Përveç këtyre me grafik janë paraqitur edhe llojet e të ardhurave për secilin nga vitet. (prezantimi në ekranin e sallës).

Totali i të ardhurave të veta për secilin vit është si në tabelë:

Të ardhurat	2026	2027	2028
Të ardhurat e veta	28,555,000	28,555,000	28,555,000
Transferta e pakushtëzuar	141,069,246	145,000,154	148,834,185
Transferta specifike	125,429,703	125,429,703	125,429,703
<u>Transferta e kushtëzuar</u>	108,034,000	108,034,000	108,034,000
Totali :	403,087,949	407,018,857	410,852,888

Për taksat dhe tarifat vendore:

Siç e thamë janë programuar për tre vitet e ardhshme në të njëjtin nivel sikurse për vitin 2025.

000/ lekë

Taksa mbi pasurinë	7,845
Taksa mbi ndërtesën	6,813
Taksa mbi tokën	620
Taksa mbi truallin	412
Takse fjetje në hotel	21
Taksë e ndikimit në infrastrukturë nd,reja	600
Taksë parkingu	206
Taksë vjetore qarkullimi mjeteve të përdorura	1,300
Taksë nga renta minerare	3,273
Tarifë pastrimi	4,000
Tarifë pastrimi Familjet	350
Tarifë pastrimi Institucionet	880
Tarifë pastrimi Bizneset	2,770

Tarifë Ndriçmi	380
Tarifë Ndriçmi Familjet	80
Tarifë Ndriçmi Institucionet	140
Tarifë Ndriçmi Bizneset	160
Tarifë për leie transporti	400
Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe Ad.Pyjore	3,100
Tarifë e zënieve të hapësirave publike	210
Të ardhura nga kopshtet	410
Të ardhura nga Çerdhet	210
Të ardhura nga qerate	6,500
Të ardhura te tjera	100
Shuma 1	28,555

Të ardhurat janë të shprehura edhe me grafik (prezantimi në ekranin e sallës).

Shpenzimet:

Aktiviteti ekonomik i Bashkisë është i lidhur ngushtësisht me shpenzimet per:

1. Paga dhe Sigurime shoqërore.
2. Shpenzime operative dhe mirëmbajtje, pa të cilat Bashkia nuk do të mund të përmbushë asnjë prej detyrimeve të veta.
3. Investime kapitale .
4. Transferta (Këshilli i qarkut, Fondi rezervë, emergjenca dhe kontigjenca etj).

PROGRAMET EKONOMIKE: (Të gjitha programet përmbajnë funksionet)

AA155 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi.

-01110 Administrimi dhe menaxhimi

-01170 Gjendja Civile

AB155 Siguria publike.

-03140 Policia Bashkiake

-03280 Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

-03280 Emergjencat civile

-06140 IVMT

AC155 - Zhvillimi Ekonomik dhe Rural.

-04240 Ujitja dhe Kullimi

-04260 Administrimi pyjor

-04220 Bujqësia dhe Veterinaria

AD155 - Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale.

-09120 Arsimi bazë

-09230 Arsimi i mesëm

-10430 Çështjet sociale dhe Çerdhe ditore

-10661 Strehimi social

AE155 - Punët Publike.

-04520 Rrugët rurale

-05100 Menaxhimi i mbetjeve

-06260 Shërbimet publike

AF155 - Fondi Rezervë dhe Kontigjencë.

- 4910 Fondi rezervë .

- 4940 Fondi kontigjencës.

Risitë që sjell metodologjia e re për përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm:

- Sic shihet më sipër PBA 2026-2028 ka 6 Programe buxhetore nga 13 që ishin.
- Bashkia Fushë -Arrëz është përzgjedhur nga Ministria e Financave dhe Financat Lokale në grupin e bashkive pilot për metodologjinë e re të buxhetimit.
- Programt përmbajnë të gjitha funksionet që bashkia buxheton duke përdorur kode produkti për secilin funksion.

TABELA E BUXHETIT SIPAS PROGRAMEVE:

Programet	2026	2027	2028
AA155 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	88,439,766	92,370,674	96,204,705
AB155 - Siguria publike	41,456,187	41,456,187	41,456,187
AC155 - Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	29,419,064	29,419,064	29,419,064
AD155 - Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	63,586,034	66,786,034	66,786,034
AE155 - Punet Publike	178,186,898	174,986,898	174,986,898
AF155 - Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	2,000,000	2,000,000	2,000,000

Kjo ishte një panoramë për PBA 2026-2028.

Faleminderit!

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Nuk ka diskutime, falenderoj Drejtorin e Zyrës së Financës Z. Dritan Lika për punën voluminoze dhe ftoj Këshilltarët ta miratojmë me votë Projektvendimin për miratimin e Fazës së Parë të PBA-së 2026-2028.

➤ **Miratohet** Projektvendimi për miratimin e Fazës së Parë të PBA-së 2026-2028 me:

9 vota pro

0 votë kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 7 e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

Ka një kërkesë të adresuar vetëm për njohje nga Këshilli Bashkiak, nga Kryetari i Fshatit Qebik, Z. Kristin Jaku, Njësia Administrative Blerim. Njëkohësisht kërkesa i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë. (Lexohet kërkesa).

Kryetari i Bashkisë i është përgjigjur me një shkresë ku i drejtohet Kryetarit të Fshatit Qebik dhe njëkohësisht për dijeni, Administratorit të Njesisë Administrative Blerim. (Lexohet shkresa me përgjigjen).

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Fushë-Arrëz më parë ka marrë një Vendim për delegimin e Administrimit të Ujësjetllësit të Fushë-Arrëzit një kompanie SHA në Shkodër. Realisht Ujësjetllësi është nën menaxhimin e pushtetit qendror përmes SHA-ve

Prandaj ne si institucion do të ndjekim gjithë procedurat ligjore që lidhen me situatë të tilla.

Hil Curri, Kryetar Bashkisë:

Ne si institucion do të ndjekim gjithë procedurat ligjore që lidhen me një situatë të tillë.

Përveç kësaj nga ana jonë do të ketë lehtësim të procedurave gjithnjë brenda kornizës ligjore.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 8 e rendit të ditës:

Pika numër 8 e rendit të ditës nuk ka objekt për diskutim.


Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Benjona Moriku
Zef Gera
Tereze Dema
Valentina Lleshaj
Vjollca Tobackaj

Franc Doda
Mustafë Teki
Bashkim Dafa
Valentin Doda